



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1015/26 Datë: 29.06.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 151 të mbajtur më 16.06.2026, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Kolegjit Universum - dega në Ferizaj.

- *Gjuhë Angleze - Përkthim dhe Interpretim, Bachelor Profesional 180 ECTS;*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Universum - dega në Ferizaj, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuhë Angleze - Përkthim dhe Interpretim, Bachelor Profesional 180 ECTS;</i>	Bleranda Bajra Kyçyku Mandalena Salihu Kryeziu Legjenda Rama Xheneta Gërguri Nazlije Maliçi Xhelili Mentor Abdullahu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegji Universum - dega në Ferizaj. Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit për këtë program dhe për 7 fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Gjuhë Angleze - Përkthim dhe Interpretim, Bachelor Profesional 180 ECTS; vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 13.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final ka konstatuar se Kolegji Universum - dega në Ferizaj nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush dy (2) fushë të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Nuk i përmbushë kriteret, dy (2) fushë të standardeve të akreditimit;

Referuar nenit 9 të Rregullores (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit e cila në paragrafin 4 thotë, citim:

“4. Standardet për vlerësimin e programeve të studimit Baçelor dhe Master, Fusha Standarde 3 lidhur me Stafin Akademik, dhe Fusha Standarde 7 lidhur me Infrastrukturën dhe Burimet janë të detyrueshme. Në kuadër të Fushës Standarde 3, standardi 3.2 është i detyrueshëm gjithashtu. Asnjë akreditim i programeve në nivelin Baçelor apo Master nuk mund të jepet përveç nëse të dyja standardet e sipërpërmendura janë përmbushur qoftë në nivel substancial apo në nivel plotësisht në përputhje. “

Prandaj referuar raportit të ekspertëve përkatësisht tabelës së vlerësimit të fushave të standardeve, fusha 3 dhe 7 e standardeve është “Non compliant” – Nuk i përmbushë standardet minimale të akreditimit andaj dhe rekomandimi final është negativ “Non compliant” dhe pragrami nuk akreditohet.

Andaj Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 151-të, të mbajtur më datë 16.06.2026, referuar bazës ligjore të cekur më lartë dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit ***për programin e studimit; Gjuhë Angleze - Përkthim dhe Interpretim, Bachelor Profesional 180 ECTS të Kolegjit Universum - dega në Ferizaj*** vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum - dega në Ferizaj
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë